



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 korrik 2012
Nr. ref.: RK/277/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI55/11

Parashtruesi

Fatmir Pireci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.
nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fatmir Pireci, me vendbanim në Prizren.

Vendim i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010, që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 dhjetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 22 prill 2011 me të cilën kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010.
4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 prill 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 28 prill 2011, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. 55/11, e emëroi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën datë, me Vendim Nr. KSH. 55/11, e emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (Kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami. Më 2 korrik 2012, me Vendim nr. GJR. KI 55/11 Kryetari e zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj me gjyqtarin Kadri Kryeziun si Gjyqtar Raportues pasi që mandati i gjyqtarës Gjyljeta Mushkolaj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese kishte mbaruar më 26 qershor 2012. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendim nr. KSH 55/11 e zëvendësoi anëtarin e Kolegjit Shqyrtues gjyqtarin Iliriana Islami me gjyqtarin Altay Suroy pasi që mandati i gjyqtarës Iliriana Islami si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese kishte mbaruar më 26 qershor 2012.
8. Më 26 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës së Qarkut në Prizren.
9. Më 21 qershor 2011, Gjykata ua dërgoi Qeverisë, Zyrës së Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme: KPM) këto pyetje:

“ ...

a. A jeni njoftuar nga parashtruesi i kërkesës që vendimi i Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 i datës 25 qershor 2008 nuk është zbatuar nga Komuna e Prizrenit?

b. Çfarë veprime keni ndërmarr ju sipas Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, pasi parashtuesi i kërkesës ju ka njoftuar që vendimi i Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 i datës 25 qershor 2008 nuk është zbatuar nga Komuna e Prizrenit?

c. Si ekzekutohen vendimet e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës sipas Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mënyrë që parashtuesi i kërkesës ta fitojë të drejtën që i është dhënë atij me vendimin e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 të datës 25 qershor 2008?

...

10. Më 27 qershor 2011, KPM u përgjigj duke thënë se ata ishin njoftuar nga parashtuesi i kërkesës se vendimi i KPM-së nuk po zbatohet dhe se këtë informacion KPM ia kishte përcjellë Kuvendit. Më tej, KPM-ja theksoi se vendimet e KPM-së duhet të zbatohen, përndryshe vendimet e KPM-së i nënshtrohen procedurave përmbarimore pranë gjykatave kompetente. Një numër i madh i vendimeve të KPM-së janë përmbaruar përmes procedurës përmbarimore nga gjykata kompetente. Më tutje, KPM i dorëzoi Gjykatës një vendim të Gjykatës Komunale në Prishtinë (Vendimi E. nr. 1155/10 i 14 janarit 2011), ku Gjykata Komunale kishte lejuar propozimin për përmbarim të vendimit të KPM-së në mbështetje të nenit 28.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe neneve 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit për KPM-në.
11. Më 1 korrik 2011, Gjykata i kërkoi parashtuesit të kërkesës të dorëzonte dëftesën e pranimi të vendimit të Gjykatës së Qarkut. Ai bëri këtë më 13 korrik 2011.
12. Më 5 korrik 2011, Kuvendi iu përgjigj Gjykatës se i kishte dërguar një raport Zyrës së Kryeministrit për këtë çështje dhe konstatoi se vendimi i KPM-së nuk ishte përmbaruar.
13. Më 12 korrik 2011, Zyra e Kryeministrit iu përgjigj Gjykatës duke thënë se e kishin njoftuar parashtuesin e kërkesës dhe KPM-në se vendimi i KPM-së është dashur të përmbarohet.
14. Më 9 korrik 2012, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 31 janar 2008, me Vendim Nr. 01/118-374, Zyra e Personelit e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e Komunës së Prizrenit ia ndërpreu kontratën e punës parashtuesit të kërkesës, pasi që pozita "Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv" nuk parashihej me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30). Ndaj këtij vendimi parashtuesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Bordin e Ankesave pranë Komunës së Prizrenit.
16. Më 15 shkurt 2008, ankesa e parashtuesit u refuzua nga Bordi i Ankesave dhe vendimi për ndërprerjen e kontratës së punësimit parashtuesit të kërkesës u vërtetua (Vendimi Nr. 01/118-496). Ndaj këtij vendimi, parashtuesi i kërkesës parashtrroi ankesë në KPM.
17. Më 25 qershor 2008, KPM-ja e miratoi ankesën dhe urdhëroi punëdhënësin që ta kthente në punë parashtuesin e kërkesës (Vendimi Nr. 49/08). KPM-ja theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut

2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: “Rregullorja e UNMIK-ut 2008/12”) nuk e parasheh ndërprerjen e kontratës së punësimit në bazë shuarjes së vendit të punës, kur kontrata është ende vlefshme. KPM-ja dha arsyetimin se vetëm nëse ka skaduar kontrata e punësimit atëherë punëdhënësi mund të refuzojë vazhdimin e kontratës së punësimit në bazë të shuarjes së vendit të punës. Kështu nuk ka ndodhur me parashtruesin e kërkesës pasi që kontrata e tij punësimit ishte ende e vlefshme. Vendimi i KPM-së ishte i formës së prerë.

18. Më 2008, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës se vendimi i KPM-së ishte shpërfillur nga Komuna e Prizrenit.
19. Më 13 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës i rekomandoi parashtruesit të kërkesës që të paraqiste padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit.
20. Më 30 prill 2010, me Vendim AC. nr. 518/2010, Gjykata Komunale në Prizren e hodhi poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim të vendimit të KPM-së. Gjykata Komunale theksoi se vendimi i KPM-së ishte vendim i nxjerrë nga një organ administrativ që nuk kishte asgjë të bënte me kërkesë në të holla siç parashihet me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Rrjedhimisht, vendimi i KPM-së nuk ishte titull përmbarimor të cilin Gjykata Komunale duhej përmbaruar, por ishte në kompetencat e KPM-së që, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2008/12, të përmbaronte vendimet e veta.
21. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale (AC. nr. 518/2010).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, ku thuhet se *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”* Në këtë kuptim, kërkesa është parashtruar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që ka të drejtë ta ngrehë këtë rast në Gjykatë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës.
24. Përveç kësaj, sa i përket kriterit për parashtrimin e kërkesës nga ana parashtruesit brenda afatit prej 4 muajsh nga data e marrjes së vendimit të fundit gjyqësor në këtë rast, Gjykata përcakton se Gjykata e Qarkut në Prizren e nxori vendimin Ac. nr. 518/2010 më 26 nëntor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës e mori vendimin më 17 dhjetor 2010. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 22 prill 2011. Parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht e ka respektuar afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.
25. Përveç kësaj, në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Gjykata e Qarkut në Prizren konsiderohet “gjykatë e shkallës së fundit për gjykimin e çështjeve që ndërlidhen me përmbarimin”. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion në bazë të ligjeve të Kosovës. ..

26. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka respektuar nenin 48 të Ligjit: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”* Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 24 [Titulli ekzekutiv] i Ligjit për Procedurën Përmbartimore i cili në pikën b) përcakton se:

Neni 24.1: *Titujt ekzekutiv janë:*

[...]

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative [...]. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

27. Pasi që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka respektuar afatet për parashtrimin e kërkesë në Gjykatë, i ka shterur të gjitha mjetet juridike dhe i ka qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, përfshirë vendimin të cilin e konteston, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

28. Pasi që parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale të pranueshmërisë, Gjykata duhet të shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit.
29. Në lidhje me parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston vendimin Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të datës 26 nëntor 2010, me të cilin u vërtetua vendimi i Gjykatës Komonale për mospërmbartimin e vendimit të KPM-së.
30. Gjykata vëren se, më 25 qershor 2008, KPM-ja e miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e urdhëroi punëdhënësin që ta kthente në punë parashtruesin e kërkesës (Vendimi Nr. 49/08). KPM-ja theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2008/12) nuk parasheh ndërprerjen e kontratës së punësimit në bazë të shuarjes së vendit të punës, kur kontrata e punësimit është ende e vlefshme. KPM-ja dha arsyetimin se vetëm nëse ka skaduar kontrata e punës atëherë punëdhënësi mund të refuzojë vazhdimin e kontratës së punës në bazë të shuarjes së vendit të punës. Kështu nuk ka ndodhur me parashtruesin e kërkesës pasi që kontrata e tij punësimit ishte ende e vlefshme. Vendimi i KPM-së ishte i formës së prerë.
31. KPM-ja u themelua në shtator 2004 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës të 22 dhjetorit 2001. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.*
32. Detyrat dhe përgjegjësit e KPM-së u riafirmuan më vonë me nenin 101.2 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili parashikon: *Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil [...]*.
33. Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i miratuar nga Kuvendi më 15 korrik 2010 dhe në zbatim të nenit 101.2 të Kushtetutës, në nenin 3 parashikon: *“Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin*

e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.” Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se vendimet e KPM-së janë të formës së prerë dhe të zbatueshme në procedurën administrative dhe se ankesa ndaj vendimeve të KPM-së në bazë të nenit 14 [E drejta e ankesës] nuk e ndalon përmbarimin e këtyre vendimeve. Përveç kësaj, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/12, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 11 [Ankesat] parasheh: “*Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi*”. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Komuna e Prizrenit nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim gjyqësor në gjykatën kompetente, me ç’rast ka pranuar obligimin për përmbarimin e vendimit të KPM-së brenda afatit ligjor.
36. Po ashtu KPM-ja, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës më 27 qershor 2011, theksoi se vendimet e tij duhet të përmbarohen, dhe nëse kjo nuk ndodh, ato i nënshtrohen procedurave përmbarimore pranë gjykatave kompetente. Më tutje, KPM i dorëzoi Gjykatës një vendim të Gjykatës Komunale në Prishtinë (Vendimi E. nr. 1155/10 i 14 janarit 2011), ku Gjykata Komunale kishte lejuar propozimin për përmbarim të vendimit të KPM-së në mbështetje të nenit 28.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe neneve 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit për KPM-në. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.
37. Gjykata vëren se gjithashtu edhe Zyra e Kryeministrit në përgjigjen e dërguar në Gjykatë theksoi vendimi i KPM-së është dashur të përmbarohet dhe se Kuvendi në përgjigjen e tij të datës 13 nëntor 2008, i rekomandoi parashtruesit të kërkesës që të paraqiste kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e vendimit të KPM-së.
38. Pa marrë parasysh këtë situatë juridike, më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale të 30 prillit 2010, me ç’rast kërkesa e parashtruesit për përmbarim të vendimit të KPM-së të 25 qershorit 2008 u refuzua dhe konkludoi që, në bazë të nenit 23 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit Nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore, vendimi i KPM-së nuk ishte titull përmbarimor i vlefshëm për kthim në punë. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.
39. Në bazë të fakteve të lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka bërë çdo përpjekje të mundshme për të shfrytëzuar të gjitha mjetet që i ka në dispozicion në bazë të ligjeve të Kosovës që të përmbarohet vendimi i KPM-së, por që, me gjithë përpjekjet e tij, vendimi i KPM-së nuk është zbatuar as nga organet përgjegjëse komunale, dhe as nga gjykatat kompetente, siç ka kërkuar parashtruesi i kërkesës.
40. Vendimi i KPM-së, që kishte marrë formë të prerë pasi që Komuna e Prizrenit nuk kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim gjyqësor pranë gjykatës kompetente, mbetet i papërmbaruar për arsye se Komuna e Prizrenit si dhe gjykatat kompetente, të cilat është dashur ta përmbarojnë vendimin e KPM-së me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, e injoruan obligimin ligjor që e kishin në bazë të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, dhe kështu shkelën parimin e sundimit të ligjit që është bazament i rendit juridik të Kosovës.
41. Ky rast duhet të kuptohet se ngrit çështje jo vetëm në kuptim të nenit 24 [Titulli ekzekutiv] i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, por edhe në kuptim të nenit 31 [E

drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], që garanton mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurat pranë gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të pushteteve publike. Është e qartë se autoritetet komunale dhe gjykatat kompetente kanë vepruar në kundërshtim me këto nene, duke mos zbatuar vendimin e KPM-së që në pajtim me Ligjin për KPM-në kishte marrë formë të prerë dhe ishte bërë i përmbarueshëm.

42. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën e prerë dhe janë të përmbarueshme. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhje të re të rastit (shih, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, GJEDNJ 2002-VII). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme. (shih, Pecevi kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008 Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).

43. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu konsideron se rasti i tanishëm duhet kuptuar se ngrit çështje edhe në kuptim të nenit 54 të Kushtetutës, që parashikon se:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

44. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se, pasi që KPM-ja kishte gjetur shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për punë, vendim ky që kishte marrë formë të prerë dhe ishte bërë i përmbarueshëm, parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë për mjete efektive juridike, pasi që Komuna e Prizrenit refuzoi të përmbarojë vendimin e KPM-së. Sidoqoftë, siç përmendet më lart, në vend të përmbarimit të vendimit të KPM-së, gjë që e kishin obligim ligjor, që të dyja Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut refuzuan ta bënin këtë.

45. Duke mos përmbaruar vendimin e KPM-së të 25 qershorit 2008, autoritetet përkatëse ua kanë privuar dispozitave të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së çdo efekt të dobishëm.

46. Neni 13 i KEDNJ-së parashikon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

47. Në këto rrethana, Gjykata gjen se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe se Vendimi i formës së prerë dhe i përmbarueshëm i KPM-së, Vendimi nr. 49/08 i 25 qershorit 2008, duhet të përmbarohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI


- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;
- II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010, i cili shkel nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.
- III. TA KTHEJË Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010 në Gjykatën e Qarkut në Prizren për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;
- IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Prizren duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues



Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojca

Dispozitat e aplikueshme ligjore në lidhje me procedurat e përmbarimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji (Nr. 03/L-008) për Procedurën Përmbarimore i 2 qershorit 2008

Rregullat ligjore, procedurat e përmbarimit dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Neni 1.

“ ...

1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

...”

Neni 24 [Titulli ekzekutiv]

“ ...

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ;*
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër ;*
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;*
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.*

...”

Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

“ ...

26.3 Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

...”

Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

“ ...

294.1 Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga

dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara.

...

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës e 27 shkurtit 2008

Neni 11 [Ankesat]

“ ...

11.6 Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi.

...”

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i datës 15 korrik 2010

Neni 13 [Vendimi i Këshillit]

“ ...

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

...”

Neni 14 [E drejta e ankesës]

“ ...

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

...”

Neni 15 [Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit]

“ ...

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga

dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.

3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

5. Këshilli duhet të njofton me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.

...”